



# UNIVERSITETI SHETËTOR I TETOVËS

STATE UNIVERSITY OF TETOVA - ДРЖАВЕН УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО

Office for International Relations, SUT Rectorate - Ilinden b.b, 1200 Tetovo, Macedonia

Tel: +389 44 356 500; Fax: +389 44 334 222

Në bazë të marrëveshjes në mes të Agjencionit për Programe Mësimore Evropiane dhe Mobilitet dhe Universitetit Shtetëror të Tetovës (MKLLP\_ERA\_A3.2\_2009\_001) dhe marrëveshjeve bilaterale të nënshkruara me universitetet e jashtme, Universiteti Shtetëror i Tetovës shpall

## K O N K U R S

për pjesëmarrje të stafit akademik në Programin ERASMUS, gjatë semestrit veror të vitit akademik 2009/2010.

### 1. KUSHTET E PËRGJITHSHME

- Konkursi shpallet për pjesëmarrje në programin e mobilitetit të stafit akademik për mbajtje të ligjeratave në ndonjë universitet partner të USHT-së
- Konkursi shpallet në bazë të marrëveshjeve bilaterale për Erasmus që USHT-ja i ka nënshkruar me universitetet partnere (shih listën e bashkangjitur në fund të këtij konkursi)
- Të drejtë paraqitjeje në konkurs kanë **profesorët dhe bashkëpunëtorët** e punësuar në USHT, të cilët e zotërojnë gjuhën angleze në nivel që kërkohet për të ligjeruar në fakultetin përkatës të universitetit partner.
- Kusht është mbajtja e së paku **5 orëve mësimore**.
- Kandidati duhet paraprakisht të kontaktojë universitetin partner për të përgatitur **planin e punës** dhe periudhën e qëndrimit të universitetin e huaj.
- Kandidatëve të përzgjedhur do t'u jepet **kompensim financiar**, që përfshin mëditje, sipas rregullave të përcaktuara nga Agjencioni për Programe Mësimore Evropiane dhe Mobilitet (varet nga vendi ku qëndrohet) dhe harxhime reale të rrugës. Nuk përfshihen harxhime të shkaktuara nga transporti me veturë personale dhe harxhime të transportit lokal.

### 2. APLIKIMI

**Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:**

- **CV** – autobiografi (në Europass format)
- Vërtetim për njohjen e gjuhës angleze

- **Vërtetim për punësim në USHT (në marrëdhënie të rregullt apo të angazhuar)**
- **Propozim-plan të aktiviteve** që planifikohen të realizohen gjatë qëndrimit në universitetin e huaj.
- **Dokumentacioni dorëzohet** tek Koordinatori Universitar për Erasmus i USHT-së, Valon Abdiu në Zyrën për Marrëdhënie me Jashtë, në Rektorat, **më së voni deri më 2 prill 2010.**
- Dokumentacioni jo i plotë nuk do të merret në shqyrtim.

### 3. PËRZGJEDHJA

- **Përzgjedhja e kandidatëve** do të bëhet nga Komisioni për shqyrtim dhe vlerësim. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve do të jenë: cilësia e propozim planit, mënyra e përcjelljes së përvojës së fituar pas kthimit në universitetin amë, si dhe dobia për punën e mëtutjeshme në USHT.

Për informata plotësuese në lidhje me këtë konkurs mund të drejtoheni te, Koordinatori Universitar për Erasmus, Valon Abdiu, në Zyrën për Marrëdhënie me Jashtë, në tel: 044-356-524, apo në e-mail: [valon.abdiu@unite.edu.mk](mailto:valon.abdiu@unite.edu.mk)

**Lista e universiteteve me të cilat USHT-ja ka nënshkruar marrëveshje bilaterale për bashkëpunim në kuadër të programit Erasmus për vitin akademik 2009/2010:**

Nr.	Emri i Fakultetit-Universitetit partner	Numri i stafit akademik
1.	Fakulteti Juridik, Universiteti Eötvös Loránd, Budapest, Hungari	1
2.	Fakulteti Ekonomik dhe i Biznesit, Universiteti i Mariborit, Slloveni	1
3.	Fakulteti i Inxhinjerisë Elektrike dhe Shkencave kompjuterike i Universitetit të Mariborit, Slloveni	1
4.	Departamenti i Gjuhës Angleze, Fakulteti Filozofik i Universitetit të Mariborit, Slloveni	1
5.	Akademia e Arteve dhe Dizjanit Eugeniusz Geppert, Wroclaw, Poloni	1